


## Migracioni, ekstremizmi dhe lojërat e rrezikshme të fajësisë

### Zhvillimet dhe dinamikat në Serbi

Ardhja e shpejtë e qindra mijëra migrantëve në Bashkimin Evropian (BE) nga Lindja e Mesme, Azia Jugore dhe Afrika duke filluar nga viti 2015 përkoi me një rritje të mbështetjes për retorikën kundër imigrantëve dhe për ekstremin e djathtë në shumë vende të Evropës. Një numër i konsiderueshëm i këtyre migrantëve erdhën në BE nëpërmjet asaj që u bë e njohur si "Balkan Route" (Ruga Ballkanike), një rrugë kryesore tokësore transiti që kalon nëpër Ballkanin Perëndimor. Megjithatë, në vitin 2016, rruja u "mbyll" zyrtarisht, duke lënë plotësisht të bllokuar në Ballkan shumë nga ata njerëz që përpinqeshin të arrinin në Evropë. Në vitin 2020, për shembull, kishte në çdo kohë rreth 7000 migrantë dhe refugjatë të pranishëm brenda kufijve të Serbisë. Prania e migrantëve brenda vendeve të Ballkanit nuk kaloi pa u vënë re dhe, në disa raste, madje nxiti rritjen e aktivitetit brenda për brenda dhe mobilizimin e aktorëve të ekstremit të djathtë që kundërshtonin praninë e tyre në rajon. Nëpërmjet shqyrtimit të këtij fenomeni, ky raport fokusohet në dinamikën rreth migracionit dhe reagimet ndaj tij të ekstremit të djathtë në Serbi, një nga vendet në "Balkan Route" (Ruga Ballkanike).

Per me shume, shihni: Marina Lažetić, [Migracioni, ekstremizmi dhe lojërat e rrezikshme të fajësisë: Zhvillimet dhe dinamikat në Serbi \(përbledhje ekzekutive\)](#), RESOLVE Network, 2022.



### Migracioni: Një kornizë e re për një fenomen të vazhdueshëm

Organizimi mes ekstremit të djathtë serb dhe qëndrimet ideologjike brenda saj kanë qenë historikisht të rrënjosura thellë në idenë e nevojës për të mbrojtur "identitetin kombëtar" të Serbisë nga armiqtë e perceptuar. Ndërkohë që roli i "armikut" u është veshur entiteteve të ndryshme përgjatë dekadave, vitet e fundit brenda ekstremit të djathtë serb është shfaqur një narrativë e fortë kundër imigrantëve dhe refugjatëve, duke i portretizuar ata si entitete, kultura dhe vlerat e të cilave kërcënojnë popullin serb dhe identitetin e tij.



## Një krizë në përkeqësim: Ndikimi i pandemisë

Situata e pasigurt e disa mijëra migrantëve që kishin ngecur në Ballkan në përpjekje për të arritur në Evropën Perëndimore, së bashku me intensifikimin e fushatave kundër imigrantëve, është përkeqësuar më tej nga COVID-19. Ndërsa pandemia ka përkuar me një rritje të retorikës kundër imigrantëve në nivel global, me efektin e integrimit të disa ideve dhe diskursit të ekstremit të djathtë.



## Euroskepticizmi: Forcimi i axhendës së ekstremit të djathtë serb

"Kriza e migracionit" së bashku me pandeminë kanë përkeqësuar ndjenjën se Bashkimi Evropian e braktisi Ballkanin Perëndimor duke e lënë të vetëm në zgjidhjen e çështjes së migracionit ndërkohë që BE-ja i siguroi kufijtë e saj. Perceptime të tillë për BE-në mendohet se po u hapin hapësirë fuqive të tjera të jashtme që të shpallin interesat dhe ndikimin e tyre dhe janë forcuar nga përfaqësuesit e lartë politikë.

## RESOLVE NETWORK

Hulumtim më i thelluar | Praktikë e bazuar në informacion | Politika të përmirësuara  
kundër ekstremizmit të dhunshëm  
[www.resolvenet.org](http://www.resolvenet.org) | [@resolvenet](https://twitter.com/resolvenet)

RESOLVE“ e ka selinë në Institutin e Paqes të SHBA-ve dhe mbështetet në trashëgiminë dhjetëra vjeçare të angazhimit të thellë të Institutut të komunitetet e përfshira nga konflikti.